

GJIMNAZI SHEMBULL I MIRË PËR ARSIMIN NË KOSOVË

Prizren, 1 shkurt

Gjimnazin Loyola në Prizren, në orët e pas ditës së vonshme i shoqëruar edhe nga kryetari i komunës Ramadan Muja e ka vizituar Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj. Në këtë gjimnaz mësimit i ndjekin rreth 500 nxënës, ndërsa është ndërtuar nga donacionet gjermane. Ministri Hoxhaj është pritur nga drejtuesit e kësaj shkolle, në emër të të cilëve Walter Happel drejtori i gjimnazit klasik "Loyola" ka theksuar se gjimnazi "Loyola" zhvillon mësimin me një program special të harmonizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, qëllimi i të cilit është hapja e mundësive të reja për nxënësit kosovarë. Puna në këtë gjimnaz është vlerësuar lart nga ministri Hoxhaj, i cili tha se puna e bërë në këtë

shkollë është shembull i mirë për Kosovën që tregon cilësinë e arsimit dhe në të njëjtën kohë tregon se si arrihen standardet evropiane në edukim.

Duke premtuar mbështetje dhe përkrahje për këtë institucion shkollor ministri Hoxhaj tha se është këtu që ta konfirmoj se nuk do të mungojnë përpjekjet në mbështetje të punës së këtij institucioni shkollor, që është element crucial i identitetit të Prizrenit dhe i arsimit të Kosovës. Ministri Hoxhaj theksoi se prioritetet e Ministrisë së Arsimit në Kosovë për sa i përket infrastrukturës shkollore këtë vit do të jenë largimi i nxënësve nga kontejnerët shkolla, renovimi i objekteve të vjetra shkollore si dhe ndërtimi i objekteve të reja shkollore nëpër

qytete ku pas lufte është shtuar numri i popullatës për shkak të migrimeve fshat-qytef. I pyetur për fatin e universiteteve private, ministri Hoxhaj ka paralajmëruar masa të cilat do ta krijojnë një rregull, duke vënë në funksione dhe një agjension ndërkombëtar të akreditimit, ashtu siç veprohet edhe nëpër vende të tjera. Për këtë qëllim ne kemi hapur konkursin, kështu që nga muaji maj nuk do të lejohej që të hapen universitete private, ashtu siç është vepruar deri më tash tha ai dhe shtoi se do të angazhohemi pra që në arsimin e lart të vendoset rend dhe rregull dhe se diplomat e studentëve që studiojnë në këto fakultete të jenë të pranueshme në të gjitha vendet.

Rami Berisha